



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA

PARTNERITETI PËR QEVERISJEN E HAPUR (OGP)

SHËNIMET E DISKUTIMEVE

TË WORKSHOPIT ME GRUPIN E KOORDINATORËVE TË OGP-së

Vendi: COD – Qendra për Hapje dhe Dialog, Zyra e Kryeministrit

Data: 25 Qershor 2018

Drejtuar nga: Drejtoria e Politikave dhe Sistemit për Mirëqeverisje, Njësia e Politikave dhe Mirëqeverisjes, Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes, Kryeministria

Workshopi i organizuar nga Drejtoria e Politikave dhe Sistemit për Mirëqeverisje, DZHM, në kuadër të Partneritetit për Qeverisje të Hapur u fokusua në hapat që do të ndiqen për mbarëvajtjen e këtij procesi dhe hartimit të Planit të Veprimit 2018-2020, si edhe lidhjen me Grupet e Menaxhimit të Integruar të Politikave.

Në hapjen e workshopit u vlerësua angazhimi i institucioneve në këtë proces, i cili do të koordinohet në nivel operacional nga DZHM në rolin e sekretariatit teknik për Grupin e Menaxhimit të Integruar të Politikave për Mirëqeverisjen dhe Administrimin Publik. Ky mekanizëm ofron një qasje të integruar për koordinimin, menaxhimin, zbatimin dhe monitorimin e arritjeve të zhvillimit të qëndrueshëm të politikave të mirëqeverisjes dhe përbën një platformë të qëndrueshme edhe për zhvillimin e procesit të OGP.

Deri tani janë ndërmarrë hapat e mëposhtëm me qëllim hartimin e Planit të Veprimit:

- Është dërguar shkresë zyrtare¹ institucioneve për caktimin e koordinatoreve me qëllim krijimin e rrjetit të koordinatoreve kombëtarë për OGP.
- Është dërguar shkresë zyrtare² me paketën metodologjike për hartimin e Planit të Veprimit 2018-2020 (PV)
- Workshopi i organizuar ka për qëllim qartësimin e mekanizmit institucional të këtij procesi si edhe metodologjinë e hartimit të PV III 2018-2020.

¹ Shkresë 2470 prot, datë 21.05.2018, lëndë "Për caktimin e koordinatorit për Partneritetin e Qeverisjes së Hapur"

² Shkresë 2783prot, datë 11.06.2018 "Përcjellja e paketës metodologjike për hartimin e Planit të Veprimit 2018-2020 e Partneritetit për Qeverisje të Hapur për Koordinatorët; Shkresë 3004prot, datë 22.06.2018 "Përcjellja e paketës metodologjike për hartimin e Planit të Veprimit 2018-2020 e Partneritetit për Qeverisje të Hapur për udhëheqësit e komponentëve/Lead Component"

Paketa metodologjike përbëhet nga 5 anekse (shtojca) lidhur me mënyrën e operimit (hartimi, roli i përfaqësuesit të 4 komponentëve kryesorë (4 lead components), kuadri institucional, masat prioritare të parashikuara në Plan-Veprim, si edhe kalendari i punës së grupit koordinator)

Në takim u diskutua lidhur me institucionet që do të luajnë rolin drejtues në përputhje me 4 komponentët e PV:

- Komponenti 1 drejtohet nga MFE përmes Komitetit të Menaxhimit të Financave Publike
- Komponenti 2: drejtohet nga Agjencia Kombetare për Shoqërinë e Informacionit përmes GT E-Gov dhe Shërbimit Publik, GMIP Mirëqeverisja dhe Administrimi Publik
- Komponenti 3: drejtohet nga Departamenti i Zhvillimit dhe Mireqeverisjes përmes GT të Politikberjes, GMIP Mirëqeverisja dhe Administrimi Publik
- Komponenti 4: drejtohet nga Ministria e Drejtësisë përmes GT të Antikorrupsionit dhe/ose Komitetit Ndërinstitucional për Strategjinë Antikorrupsion

Ndër hapat imediatë që duhet të ndërmerren në këtë kuadër janë:

- Fillimi i inicimit të procesit për hartimin e Planit në përputhje me kuadrin metodologjik;
- Përdorimi i mekanizmave ekzistues për hartimin e PV dhe raportimit të zbatimit të tij me qëllim shmangien e proceseve të dyfishta (në përputhje sipas referimeve të mësipërme për çdo komponent)
- Përcaktimi i masave të planifikuara në përputhje me SKZHI II, strategjitë sektoriale, të kostuara dhe të angazhuara në afat-shkurtër për të qene sa më konkrete dhe të matshme (PV 2018-2020).
- Kriteret e përcaktimit, prioritizimit të masave lidhen me a) rëndësinë strategjike b) përputhshmërinë me SKZHI II, strategjitë sektoriale dhe c) maturitetin (masa të kostuara dhe të financuara);
- Koordinimi i kalendarit të veprimeve (Shtojca V) nga të gjitha institucionet me qëllim hartimin e PV, në përputhje me kuadrin metodologjik.
- Dërgimi i Kalendarit për çdo komponent në përputhje me kuadrin metodologjik brenda datës 03.07.2018.

Përfaqësuesit e institucioneve të pranishëm në workshop vlerësuan mënyrën e organizimit të procesit dhe veçanërisht shfrytëzimin e strukturës së GMIP-së për Mirëqeverisjen dhe Administrimin Publik dhe Grupeve të saj Tematike për konsultimin dhe validimin e të dhënave që do të paraqiten në këtë kuadër.

Dokumentet e përgatitura në workshop:

- Agjenda
- Kuadri Metodologjik (Shtojca 1 – 5)
- Prezantimi i procesit të OGP-së
- Listë-prezenca e pjesëmarrjes
- Shkresat zyrtare